

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË, Departamenti i përgjithshëm, Divizioni Penal**, me gjyqtarin e vetëm gjykues Minir Hoti, dhe sekretaren juridike Fatmire Podvorica, në çështjen penale kundër të pandehurit F.(F.) R., nga fshati D., Komuna e P., për shkak të veprës penale Vjedhje nga neni 325 par.1 të KPRK-së, e akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP.II.nr.5844/2018 të datës 22.11.2018, në shqyrtimin fillestar publik të mbajtur në praninë e Prokurorit të shtetit Besart Mustafa, nga Prokuroria Themelore në Prishtinë dhe të pandehurit, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar më dt.09.01.2019, të njëjtën ditë mori, publikisht shpalli dhe përpiloj këtë:

## A K T G J Y K I M

I pandehuri: **F.R.**, nga i ati F., e ëma F., e gjinisë M., i lindur me *data e lindjes...*, në fshatin D., Komuna e P., ku edhe tani banon, me nr.personal *numri personal...*, ka të kryer shkollën e mesme, i papunë, i martuar, baba i një fëmijve, i gjendjes së dobët ekonomiko-sociale, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

## ËSHTË FAJTOR

### Sepse:

Me datë 29.04.2018, rreth orës 15:05, në P., në Qendrën Tregtare “Interex”, me qëllim që vetit t’i sjellë përfitim pasuror të kundërligjshëm, i pandehuri ka arritur të marr një fshesë elektrike dhe disa produkte mishi, me ç`rast të dëmtuarës “Interex”-it, i ka shkaktuar dëm material në vlerë prej 100 euro.

Më këtë ka kryer veprën Vjedhje nga neni 325 par.1 të KPRK-së.

Prandaj gjykata në bazë të neneve 4,7,17,41,50, 51, 52 dhe 73 si dhe nenit 325 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPRK-së, i shqipton:

## DËNIM ME KUSHT

- I. I pandehuri F.R.**, i shqipton dënim me burgim në kohëzgjatje prej **2 (dy) muajsh**, dhe me dënim me gjobë në shumë prej **100 euro (njëqind euro)**, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen në afatin prej **1(një) viti**, në qoftë se i pandehuri gjatë kësaj kohe nuk do të kryej veprë të re penale.
- II.** I pandehuri duke u bazuar në nenin 453 par.4 të KPPRK-së, lirohen nga pagesa e shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor për shkak të gjendjes së rëndë ekomomiko-sociale.

**III.** I dëmtuari: F.R., nga fshati B., Komuna e P., puntor në “INTEREX”, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prishtinë, me aktakuzën PP.II.nr.5844/2018 të dt.22.11.2018, ka akuzuar të pandehurin F.(F.) R., nga fshati D., Komuna e P., për shkak të veprës penale Vjedhje nga neni 325 par.1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale gjykata mbajti seancën e shqyrtimit fillestar gjyqësor më dt.09.01.2019, gjatë së cilës u dëgjuan Prokurori i Shtetit Besart Mustafa nga Prokuroria Themelore në Prishtinë dhe i pandehuri F.(F.) R.

I pandehuri, në seancën e shqyrtimit fillestar gjyqësor deklaroi se e pranon fajësinë, më vjen keq që ka ndodhur rasti, unë edhe në polici e kam pranuar fajin, i kërkoj të dëmtuarës dhe gjykatës falje, sendet që i kam marr për familjen time, sepse nuk kam pasur mundësi për ti blerë, jam i pa punë, i martuar baba i një fëmije, edhe me shëndet nuk po qëndroj mirë dhe nuk po kam mundësi të punoj, andaj e lus gjykatën që të më shqiptoj një dënim sa më të lehtë, sepse nuk kam mundësi për ta paguar, jam i pa aftë për punë dhe vazhdimisht jam me përcjellje.

Prokurori i Shtetit Besart Mustafa, nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, në fjalën e dhënë lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit deklaroi se pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, pranimi i fajësisë u bë me vullnetin e tij të plotë pa kurrfarë presioni dhe konform dispozitave ligjore të KPRK-së, andaj i propozoj gjykatës që të aprovoj pranimin e fajësisë.

Gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimi i fajësisë u bë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza dhe në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit.

Gjykata pas pranimin të fajësisë nga ana e të akuzuarit, si dhe marrjes së mendimit të palëve, respektivisht prokurorit të shtetit, si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës vërteton se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara sipas dispozitës së nenit 248 par.1 të KPRK-së, dhe e aprovoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në shqyrtimin fillestar, andaj Gjykata konform nenit 248 par.4 të KPRK-së, nuk ka zbatuar procedurën e provave por ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar edhe nga vet i akuzuari, gjykata vërteton se me veprimet inkriminuese të akuzuarit përmbushen të gjitha elementet qenësore të veprës penale Vjedhje nga neni 325 par.1 të KPRK-së, e për çka gjykata gjeti se i akuzuari në aspektin penal-juridik është përgjegjës, për çka edhe u shpallë fajtorë dhe iu shqiptua dënimi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit Gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat në llojin dhe masën e dënimit, dhe në rastin konkret si rrethana lehtësuese gjeti faktin se i pandehuri gjatë shqyrtimit fillestar gjyqësor e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, dhe ndien keqardhje për veprimet e tij për të cilët edhe i kërkon falje gjykatës dhe të dëmtuarës, i gjendjes së dobët ekonomike, i paaftë për punë, ndërsa duke e marrë parasysh shkallën e përgjegjësisë penale si rrethana rënduese gjykata gjeti dhe pati parasysh shkallën e përgjegjësisë penale të të pandehurit, intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur në këtë çështje penalo-juridike, andaj gjykata ka shqiptuar dënimin si në dispozitiv të aktgjykimit me bindje se ky dënim është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 par.1 të KPRK-së, që të parandaloj kryesen nga kryerja e veprave penale në të ardhmen të bëjë rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave të tilla penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi lirimin e të pandehurit nga pagesa e shpenzimeve të procedurës penale dhe paushalit gjyqësor u muar në bazë të nenit 453 par.4 të KPPRK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest civil është marrë në kuptim të nenit 463 par.1 dhe 2 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË**  
**Departamenti i përgjithshëm, Divizioni Penal**  
**P.nr.722/2018, më dt.09.01.2019**

**Sekretarja Juridike:**  
Fatmire Podvorica

**Gjyqtari i vetëm gjykues:**  
Minir Hoti

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet Ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmes kësaj gjykate.